

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Falsifikuan dokumentet për 6 prona në Fier, arrestohen ish-drejtori i ASHK-së dhe përfituesi
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/falsifikuan-dokumentet-per-6-prona-ne-fier-arrestohen-ish-drejtori-i-i104963
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 08:50:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 08:45:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b03957ad3498d47ae94ccc59625586f0019e2bd84695b5c4c0c503fd7588d6e9
TEKSTI	e91c2e0b599e3ac25bb47836712fa61ac91e73d640ef9264785dee22b423da9f
PAMJA	c59e7751570447a07a80ea9376cbe303c3dcebf688a0b65ca93bae0b3da57653

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7697d269a6a2ea0aa8d48280bf6771947f92ec09aee18222af006ea8e78c2a2a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d9bc965f5b1d123533150ed32fd4f601072aed3f2d6cedb2b9fe07ef4eb329bf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7697d269a6a2ea0aa8d48280bf6771947f92ec09aee18222af006ea8e78c2a2a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

[ish-drejtori i ASHK-së](#)

[E.S., dhe shtetasi E.H., i dyshuar si](#)

[kombëtares italiane](#)

[është ndarë nga jeta në moshën](#)

[i torte ne Riad, probleme](#)

[Mesme, ndërsa Arabia Saudite është goditur](#)

[klinika e mjekëve të arrestuar pas](#)

[Karneadou, Elias Theodoropoulos](#)

[duhet të adresojë Reforma](#)

AKTUALITET

Falsifikuan dokumentet për 6 prona në Fier, arrestohen ish-drejtori i ASHK-së dhe përfituesi

Piranjat Përditësimi i fundit 19 Shtator 2026, 10:45



Ish-drejtori i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Fier, E.S., dhe shtetasi E.H., i dyshuar si përfitues i gjashtë pronave të regjistruara në mënyrë të kundërligjshme, janë arrestuar me kërkesë të Prokurorisë së Fierit. Ndërkohë, ndaj ish-hartografit pranë ASHK Fier, E.R., gjykata ka caktuar masën e sigurisë “Detyrim për t’u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore”. Hetimet lidhen me procedimin penal nr. 1715, të nisur më 5 nëntor 2025, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Mashtrimi”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe “Shpërdorimi i detyrës”.

Sipas Prokurorisë, hetimi ka nisur pas dyshimeve për përfitim dhe regjistrim të kundërligjshëm të pasurive të paluajtshme në zonën e Levanit, si dhe për tjetërsimin e tyre dhe qarkullimin e parave të përfituara. Çështja lidhet me një vendim të vitit 2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përmes të cilit ishte njohur e drejta e kompensimit për 100 hektarë tokë bujqësore në zonën e Levanit dhe Dërmënasit.

NJOFTIMI I PROKURORISE

Falsifikoi dokumentet për 6 prona me ndihmën e ish-drejtorit të ASHK-së, Prokuroria e Fierit jep masën e sigurimit ‘Arrest me burg’ për dy personat nën hetim, masë edhe për topografin

Me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, u arrestuan shtetasi, E.S., ish-Drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe përfituesi i pronave, të dyshuara të marra me dokumente të falsifikuara E.H., si dhe u dha masë sigurimi ‘Detyrim për t’u paraqitur para oficerit të policisë gjyqësore’ për shtetasin E.R., ish-hartograf pranë ASHK-së Fier.

Hetimet mbi procedimin penal nr. 1715, datë 05.11.2025, për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve”, “Mashtrimi”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar respektivisht nga nenet 186, 143, 287 dhe 248 të Kodit Penal, nisën pas dyshimeve për përfitim dhe regjistrim të kundërligjshëm të pasurive të paluajtshme në zonën e Levanit, si dhe tjetërsimin e tyre dhe qarkullimin e vlerave monetare të përfituara.

Fakti penal i dyshuar lidhet me vendimin e vitit 2008 i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që parashikonte njohjen e të drejtës së kompensimit për 100 ha tokë bujqësore në zonën e Levanit dhe Dërmënasit. Një prej trashëgimtarëve përfitues, shtetasi E.H., ka përfituar më pas, me Vendimin nr. 1944, datë 26.11.2018, të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, kompensim financiar në vlerën 53.800.000 lekë.

Pavarësisht kompensimit financiar, nga hetimi dyshohet se gjatë vitit 2023, shtetasi E.H. ka ndjekur procedura për regjistrimin e 6 pasurive në ZK nr. 2436, me sipërfaqe totale rreth 71.7 ha, duke iu referuar Vendimit nr. 246, datë 21.02.2008.

Hetimi deri në këtë fazë ka evidentuar veprimet e E.S., ish-Drejtor i ASHK Fier, dhe E.R., ish-hartograf pranë ASHK Fier, lidhur me trajtimin administrativ dhe kadastral të dokumentacionit të përdorur për regjistrimin e pasurive.

Pas regjistrimit, disa prej pasurive dyshohet se janë tjetërsuar nëpërmjet shitjes, duke gjeneruar të ardhura në vlera të konsiderueshme. Hetimi vijon për verifikimin e këtyre transaksioneve,

gjurmimin e vlerave monetare dhe përcaktimin e destinacionit të tyre.

Gjatë hetimit u sekuestruan edhe 715.976 euro, të depozituar në llogarinë bankare të E.H. Si dhe janë sekuestruar dokumente, pajisje elektronike dhe materiale të tjera, të cilat do t'i nënshtrohen verifikimeve të mëtejshme.

Hetimi vijon për dokumentimin e plotë të rrethanave të çështjes, identifikimin e personave të tjerë të mundshëm të përfshirë dhe individualizimin e përgjegjësisë penale.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 19 Shtator10:35

[Bashkëshortja e Alban Hoxhës ndërroi jetë pas lindjes së djalit/ Gjykata e Lartë lë në fuqi dënimin për Elona Burbën dhe Petrit Rexhepin](#)

Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit dhe la në fuqi dënimin për dy mjekët Elona Burba dhe Petrit Rexhepi, të cilët ...

AKTUALITET 19 Shtator09:53

[Sekuestrohen mbi 400 kilogramë kanabis në frigorifer, arrestohet i riu shqiptar në Itali](#)

Policia italiane ka sekuestruar mbi 414 kilogramë hashash, me një vlerë prej mbi 4 milionë eurosh, ndërsa në pranga ka rënë...

AKTUALITET 19 Shtator09:41

[61 bashki, 312 njësi administrative/ Raporti zbardh problemet që duhet të adresojë Reforma Territoriale](#)

Reforma e re Territoriale duhet të shoqërohet me një riorganizim të plotë administrativ, financiar dhe zgjedhor të pushtetit ven...

AKTUALITET 19 Shtator08:13

[Parashikimi i moti për ditën e sotme](#)

Ditën e shtunë vendi ynë pritet të ndikohet nga kushte atmosferike të qëndrueshme, pasi moti do të karakterizohet nga kthje...

AKTUALITET 18 Shtator23:25

[Detaje/ Policia spanjolle godet rrjetin me tonelata kokainë drejtuar nga shqiptarët. Sekuestrohen 29 automjete luksoze](#)

Tre persona janë arrestuar në Pilar de la Horadada, në kuadër të një operacioni madhor të Policisë Kombëtare spanjo...

AKTUALITET 18 Shtator22:13

[Vlorë/ Zjarr në kuzhinën e një restoranti në Skelë, flakët përfshijnë garazhin nëntokësor](#)

Një zjarr ka rënë në kuzhinën e një restoranti në Skelë, ndërsa flakët kanë përfshirë edhe gara...

AKTUALITET 18 Shtator21:49

[Kush është 42-vjeçarja nga Durrësi që u përplas për vdekje nga kamioni i plehrave para syve të së bijës](#)

Një ngjarje tragjike ka ndodhur mëngjesin e së premtes në San Donà di Piave, pranë Venecias, ku një 42-vjeçare shqip...

AKTUALITET 18 Shtator20:32

[Rruga Milot-Balldren, sërish hija e Ballukut në tenderin 365 milionë euro, fitues kompania nën hetim nga SPAK](#)

Rreth 365 milionë euro për 35 vjet. Kjo është vlera e parashikuar e koncesionit Milot-Balldren, rruga 17 kilometra e gjatë që do t...

AKTUALITET 18 Shtator20:23

[Nga TikTok-u te “gara e vdekjes”, si humbën jetën 3 të rinjtë shqiptarë në Greqi](#)

Detaje të reja kanë dalë në dritë për aksidentin e rëndë të ndodhur në Glyfada të Athinës, ku humbë...

AKTUALITET 18 Shtator18:06

[E rëndë në Skrapar! Foshnja transportohet drejt Traumës, dyshohet se ka dëmtuar dorën me grirëse mishi](#)

Një foshnje 1-vjeçare është transportuar me helikopter drejt Spitalit të Traumës në Tiranë, pasi dyshohet se ka dë...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

["Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la" ...](#)

Loet kume, depueta i Partise Socialiste per Durrësin dhe prozatori e esekusi i njohur, ka njoftuar mesazhin e kesaj te premte nadi...

BOTA 18 Shtator

[VIDEO dramatike/ Të dashurës i erdhi burri, i r...](#)

Ky është momenti kur një burrë, gjysmë i zhveshur, u rrëzua nga një dritare teksa tentonte të arratisej, pasi dyshohet s...

BOTA 18 Shtator

[Ngjarje e rëndë në aeroport, avioni përfshihet ...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Libi, ku një avion i cili sapo ishte ulur, u përfshi nga flakët. Avioni privat Cessna Ci...

INVESTIGIME 18 Shtator22:42

[“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit](#)

Jemi në Tiranë, në rrugën e Durrësit, aty ku një apartament është kthyer në “mollë sherri” dhe ka ...


video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.